




Politika për arsimimin mediatik



<https://www.coe.int/en/web/freedom-expression>



**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE
AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

Reinforcing Judicial Expertise on Freedom of Expression and the Media in South-East Europe
(JUFREX)

Funded by
European Union
and Council of Europe



Implemented by
the Council of Europe

POLITIKA PËR ARSIMIMIN MEDIATIK

Ky dokument u përgatit në kuadër të projektit të përbashkët të BE-së dhe Këshillit të Evropës „Përforcimi i ekspertizës gjyqësore për lirinë e të shprehurit dhe për mediumet në Evropën Juglindore (JUFREX)”

nga Paolo Çelot

mars 2019

Dizajn grafik: MP Profil, Skopje

Përmbajtje

Hyrje

5

Bazat

7

Qëllimet

9

Sferat kryesore të zbatimit

11

Kompetencat e

13

shkrim-leximit mediatik



15 17 19 21 23

1 Vetëdija kritike

2 Vetëdija për emocionet

3 Mirëqenia digjitale

4 Qytetaria me të drejta
të plota

Rolii Agjencisë

Në periudhën ndërmjet viteve 2016 dhe 2018, Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale luajti rol të rëndësishëm në nxitjen e shkrim-leximit mediatic në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Aktivitetet e saj u zhvilluan sipas Programit¹ të veçantë, duke i angazhuar njëloj edhe subjektet relevante edhe qytetarët.

Qëllimi i këtij dokumenti është të sqarojë se çka më tutje. Ai i vërteton rezultatet nga aktivitetet² tani më të zbatuara dhe bazohet në koncepte të themeluara fuqishëm të cilat janë vërtetuar nga bashkësia shkencore ndërkombëtare dhe janë futur në politikat e Unionit Evropian dhe standardet dhe procedurat e Këshillit të Evropës³.

Këtu nuk është e nevojshme të përkujtojmë rëndësinë strategjike të aftësive për shkrim-lexim mediatic edhe në nivel individual edhe në atë nacional. Në internet ekziston bibliografi e vëllimshme, lehtë e arritshme, e studimeve dhe dokumente për politika ndërkombëtare. Realisht, përparimi teknologjik dhe ekonomik i kohëve të fundit dhe ngjarjet e mëdha shoqërore ndërkombëtare dhe ngjarjet politike, shkrim-leximit mediatic i përshkruajnë rol edhe më thelbësor kur bëhet fjalë për demokracinë në shoqëritë tona.

Hyrje

Më tej, qoftë nëse njerëzit shikohen si qytetarë, votues, konsumatorë, prindër ose fëmijë, nevoja për të investuar në aftësitë e tyre mediatike rritet shpejtë. Si shembull do ta theksojmë fenomenin e dezinformatave nëpërmjet rrjeteve sociale që shprehet kryesisht në rezultatet e zgjedhjeve ndërkombëtare; pastaj, teknikat e reja të propagandës subtile të cilat janë gjithnjë e më të vështira për tu vërejtur; shprehitë e popullatës, duke përfshirë këtu edhe fëmijët, për të kaluar shumë orë para ekranit që potencialisht mund të rezultojë me varshmëri, si dhe fakti se me qëllim që të plotësohen modelet e reja të biznesit, njerëzit dhe të dhënat e tyre personale përcillen vazhdimisht, duke ndikuar në këtë mënyrë në privatësinë dhe sigurinë e tyre.

Duhet të theksohet se në këtë dokument asnjëra nga këto çështje nuk do të shqyrtohet në detaje, sepse qëllimi është të paraqitet një koncept i cili është mjaft i gjerë që të zbatohet në të gjitha këto tema, duke i përfshirë edhe ato afirmative, siç është mundësia të krijohet dhe shpërndahet përbajtje, të lidhet me të tjerët dhe kuptimshëm të kontribuohet për shoqërinë.

Numri dhe rëndësia e koncepteve dhe temave të përmendura më lartë rritet gjithnjë e më tepër, dhe ato janë në gjendje të ndryshimit të vazhdueshëm. Me qëllim që Agjencisë t'i jepen drejtime për iniciativa të ardhshme, duke i adaptuar konceptet e pranuar ndërkombëtarisht në karakteristikat e vet vendit, do të përqëndrohemi në qasjen më të re të zhvilluar nga bashkësia për shkrim-lexim mediatic, që bazohet në vizionin inovativ dhe hulumtimet themelore.

1 „Programi për nxitje të shkrim-leximit mediatic në Republikën e Maqedonisë (2016-2018)“; i qasshëm në: http://mediumskapismenost.mk/media/2016/05/Programa_zh_mediumska_pismenost-1.pdf.

2 „Raporti për zbatimin e Programit për nxitje të shkrim-leximit mediatic në Republikën e Maqedonisë (2016-2018)“; i qasshëm në: <https://bit.ly/2H557wl>.

3 Si për shembull, Rekomandimi nga Këshilli i Evropës për pluralizëm në medime, transparencë të pronësisë mediatike dhe shkrim-leximit mediatic.



Shkrim-leximi mediatic gjithnjë e më shumë njihet si përmbledhje e aftësive të cilat kontribuojnë në luftën kundër dukurive siç janë dezinformatat dhe propaganda, kiber-dhuna dhe ndjekja, dhe të cilat mundësojnë përdorim më të mirë të teknologjisë. Ky dokument i pranon dhe i merr parasysh politikat evropiane dhe standardet dhe iniciativat e Këshillit të Evropës, si dhe aktivitetet e organizatave tjera ndërkombëtare në këtë temë.

Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale⁴, i miratuar në vitin 2013, është politikë definuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut që i përshkruan përgjegjësitë në lidhje me shkrim-leximin mediatic. Si të tilla, baza dhe motivimi për këtë dokument mbeten të njëjta. Qëndrimi i Agjencisë është të promovojë dhe inkurajojë shoqëri me shkrim-lexim mediatic nëpërmjet një sërë aktivitetesh.

Bazat

Si pjesë e përgjegjësiave të saj, sipas Programit të përmendur më lartë dhe duke marrë parasysh atë që tani më është bërë⁵, Agjencia ka për qëllim ta sqarojë vendin e shkrim-leximit mediatic dhe të paraprijë implementimin e përshtatur të tij.

Prandaj, që t'i arrijë qëllimet e synuara dhe t'i nxisë shkathtësitë dhe qëndrimet relevante, ky dokument do t'i drejtojë kompetencat që do t'i sugjerojnë iniciativat e Agjencisë për përparim dhe formësim të shkathtësive dhe qëndrimeve që do të kontribuojnë për promovimin e shkrim-leximit mediatic, dhe do të japë pasqyrë të gjërë të asaj që definojnë shkrim-leximin mediatic.

4 Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, 2013, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, numër 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19, i qasshëm në: <https://bit.ly/2HQndnJ>.

5 Shiko për shembull <http://mediumskapismenost.mk/faqa-e-pare/>, „Raporti për zbatimin e Programit për nxitje të shkrim-leximit mediatic në Republikën e Maqedonisë (2016-2018)“, i qasshëm në: <https://bit.ly/2H557wl>, „Shkrim-leximi mediatic në Maqedoni: Vegël që mungon për qytetari aktive“, i qasshëm në: „Shkrim-leximi mediatic në Maqedoni – përjekje për implementim në arsimin fillor“, i qasshëm në: <http://www.medium.edu.mk/attach/Mediumskata-pismenost-vo-Makedonija-obid-za-impelementacija-vo-osnovoto-obrazovanie-MKD.pdf>.



Qëllimi gjithëpërfshirës është të nxitet shkrim-leximi mediatic në shoqërinë e Maqedonisë së Veriut duke marrë parasysh qytetarët si shfrytëzues të fundit.

Më konkretisht:

Të aftësohen njerëzit nga grup moshë dhe segmente të ndryshme (njerëz të vjetër, të rritur, fëmijë, gra të reja etj.), duke vepruar në kapacitete dhe kontekste të ndryshme (konsumatorë, votues, qytetarë e kështu me radhë), të nxjerrin dobi nga rrethi mediatic në të cilin jetojnë.

Prandaj, aktivitetet e parapara përfshijnë një diapazon të gjerë mundësish, dhe mund të jenë ose:

- të orientuar drejtpërdrejt, si për shembull kampanja informative për ngritjen e vetëdijes dhe iniciativa tjera konkrete, ose
- aktivitete për mbështetje, për lehtësimin e proceseve të lartpërmendura në mënyrë të tërthortë, siç është nxitja e hulumtimeve ose vënia e resurseve në dispozicion të mësimdhënësve.

Qëllimet

Agjencia në mënyrë të veçantë duhet të ndihmojë, si vijon:

- të kontribuojë që qytetarët ta kuptojnë shkrim-leximin mediatic dhe ta rrisin vlefshmërinë dhe njohjen e saj (*ngritja e vetëdijes*);
- të bashkëpunojë me organizata ndërkombëtare, ministri dhe faktorë të tjerë nëpërmjet rrjetëzimit, konsultimeve dhe raporteve (*bashkëpunim dhe konsultime*);
- t'i përmirësojë kushtet për pjesëmarrje qytetare dhe demokratike, duke përfshirë edhe përsosjen e shkrim-leximit mediatic dhe parimet e saj inspiruese në politikat dhe strategjitë e saj nacionale relevante, duke përfshirë këtu edhe lirinë mediatike dhe pluralizmin (*politika dhe trende*).



SOCIAL

26/03

SOCIAL
EVENTI

SOCIAL

14/03

SOCIAL

15/03

KEY RESEARCH

VASC/SMS

TESTI
SOCIAL

KEY RESEARCH

SOCIAL

Shkrim-leximi mediatik në mënyrë transversale zbatohet në sferën ekonomike, shoqërore, kulturore dhe arsimore. Prandaj, në kuadër të një qasjeje të paramenduar mirë, mund të rradhiten shumë iniciativa të ndryshme për zbatimin e aktiviteteve në një ose më shumë prej këtyre fushave. Konkretisht, iniciativat mund të shtrihen në një diapazon të gjërë mundësish për:

- Të inkurajuar krijimin ose shpërndarjen e resurseve arsimore dhe materialeve informative,
- Të kryhen hulumtime, studime dhe analiza,
- Të organizohen trajnime për grupe të ndryshme, duke përfshirë edhe profesionistët mediatikë,
- Të përcaktohen dhe të zgjerohen praktikatat e mira,
- Të zhvillohet rrjetëzimi ndërmjet faktorëve kryesorë,
- Të organizohen dhe të merret pjesë në ngjarje shtetërore dhe ndërkombëtare,
- Të përshtaten programet mësimore shkollore,
- Të nxitet gazetari kualitative,
- Të lehtësohet përfshirja e shkrim-leximit mediatik edhe në rregullativën dhe në kodekset e sjelljes.

Sferat kryesore të zbatimit

Çdo aktivitet mund të ketë dimension nacional ose lokal.

Faktorët

Qëllimi këtu është që faktorë relevantë dhe aktorë kryesorë të jenë të gjitha organizatat publike ose private në fushën e politikave nacionale ose ndërkombëtare ose financim, në arsimin formal ose joformal dhe në sektorin mediatik ose atë qytetar.

Politika

Të përkujtojmë se shkrim-leximi mediatik është i pranishëm në Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audivizuele⁶. Në kuadër të rolit të saj si trup rregullator, Agjencia ka për detyrë t'i organizojë dhe t'i zbatojë aktivitetet për shkrim-lexim mediatik.

6 Ligji për shërbime mediatike audio dhe audivizuele, 2013, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, numër 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19, i qasshëm në: <https://bit.ly/2HQndnJ>.



Që nga studimi i parë⁷, i zbatuar për nevojat e Komisioni Evropian, shkrim-leximi mediatic ishte definuar si përmbledhje e kompetencave individuale (teknike, kognitive dhe participuese) dhe faktorëve të fushëveprimit (siç janë ligjet dhe arsimit mediatic) si faktorë kontekstualë që ndikojnë në zhvillimin e shkathtësive nga sfera e shkrim-leximit mediatic. Pasuan korniza të ngjashme, të cilat në esencë u referoheshin parimeve të njëjta.

Kompetencat e shkrim-leximit mediatic

Në vitin 2015⁸, Agjencia i ndiqte këto koncepte të vlefshme. Megjithatë, ashtu siç ndryshon bota, ekzistojnë trende më të reja mediatike që duken qartë me përparimin e teknologjive të reja, që shpejtë ndikojnë në mënyrën se si njerëzit ndërveprojnë dhe komunikojnë me mediet.

Si shembull, rrethet shoqërore dhe politike janë të goditura nga dezinformatat, njohja e „ekonomisë së vëmendjes“ ilustron se si kompanitë komerciale realizojnë fitime të mëdha nga shërbimet ‘falas’, ndërsa fluskat e rrjeteve sociale mundësojnë që porositë politike të orientohen dhe të synojnë njerëz të një mendimi, dhe kështu pjesëmarrja në debate dhe në shoqëri bëhet e polarizuar.

Shkurtimeisht, qytetarët tani popullojnë një ekosistem tejet të ri mediatic dhe duhet të mësojnë se si të jetojnë në të me qëllim që t’i shfrytëzojnë të gjitha përfitimet nga përdorimi i medieve. Ky është shkrim-leximi mediatic.

E njëjta organizatë e cila kontribuoi për të kuptuarit aktual të shkrim-leximit mediatic në Evropë tani propozon një perspektivë të përmirësuar më gjithëpërfshirëse. Ajo ka për qëllim ta lehtësojë të kuptuarit e asaj se në çfarë shkrim-leximi mediatic duhet të fokusohet fillimisht. Dokumenti i shqyrton këto koncepte me qëllim që në mënyrë më inkluzive të përballet me problemet reale të përditshme.

Ai ndjek një vizion për shkrim-leximin mediatic që nuk është vetëm përmbledhje e shkathtësive që duhet të fitohen, por edhe një numër i caktuar i qëndrimeve dhe qasjeve më të thella personale të cilat duhet të sqarohen.

Është strukturuar në katër komponentë të ndryshëm:

1. Vetëdija kritike;
2. Vetëdija për emocionet;
3. Mirëqenia digjitale;
4. Qytetaria me të drejtë të plotë.

7 “Study on Assessment Criteria for Media Literacy Levels: A comprehensive view of the concept of media literacy and an understanding of how media literacy levels in Europe should be assessed” (Studim për kriteret për vlerësim të niveleve të shkriliximit mediatic: Pikëpamje gjithëpërfshirëse mbi konceptin e shkrim-leximit mediatic dhe botëkuptimi për atë se si duhet të vlerësohen nivelet e shkrim-leximit mediatic në Evropë”), e qasshme në: https://eavi.eu/wp-content/uploads/2010/06/eavi_study_on_assessment_criteria_for_media_literacy_levels_in_europe.pdf.

8 „Programi për nxitje të shkrim-leximit mediatic në Republikën e Maqedonisë (2016-2018)”, i qasshëm në: http://mediumskapismenost.mk/media/2016/05/Programa_z_a_mediumska_pismenost-1.pdf.



Vetia kryesore e shkrim-leximit mediatik, ashtu siç e njohim, është mendimi kritik. Ky mbetet koncepti kryesor, proces kognitiv, logjik, për kuptim të informatës së pranuar. Më në fund është pranuar se mendimi kritik, e jo vetëm shkathtësitë teknike, është bërthama e shkrim-leximit mediatik.

Megjithatë, shumë njerëz nuk i arrijnë shkathtësitë që u nevojiten që të mund t'i vlerësojnë lajmet, ta kuptojnë propagandën, ta vërejnë reklamimin ose në mënyrë përkatëse të reagojnë në përmbajtjet me gjuhë të urrejtjes.

Në mënyrë që plotësisht të kuptohet një porosi mediatike, realisht nuk mjafton që njeriu vetëm të mund ta lexojë informatën në mënyrë kritike, as edhe vetëm të ndërtojë kapacitet racional për ta analizuar porosinë mediatike.

1 Vetëdija kritike

Në vend të kësaj, ajo që është e nevojshme për tu kuptuar më thellë përmbajtja mediatike, si dhe konteksti nga i cili rrjedh, *është të zbatohet mendim kualitativ si qëndrim personal dhe vlera të fuqishme si çelës i leximit.*

Prandaj, shkathtësitë për mendim kritik doemos duhet të mbështeten në aftësinë për të zhvilluar mendime të mira dhe vlera të bukura siç janë integriteti, etika, empatia dhe drejtësia.

Që të mundësohet ajo që u përmend më lartë, përvojat e shfrytëzuesve me mediet duhet të jenë të rrethuara me përmbajtje dhe njerëz të vlefshëm për zhvillim të mendimeve të dobishme. Për shembull, mund të inkurajohen njerëzit për t'i mënjeluar nga rrjetet e tyre sociale përmbajtjet dhe kontaktet nga të cilat nuk kanë dobi.

Gjatë shkrimit të statusit ose artikullit gjithashtu nuk duhet t'i fokusojmë mendimet shumë më tepër se sa kur lexojmë një përmbajtje të huaj. Edhe hulumtimi në internet është metodë e mirë për pasurim të përvojës, me kusht që njerëzit të mësojnë si dhe çka të kërkojnë, dhe të jenë të aftë t'u rezistojnë përmbajtjeve në internet që ua tërheqin vëmendjen.

Në esencë, cilësia e vetëdijes kritike përbëhet nga shkathtësitë për mendim kritik, dhe si parakusht, nga qëndrime dhe vlera personale. Ndërsa, përvoja më e shëndoshë mediatike do t'i nxisë dhe pasurojë kompetencat personale për shkrim-leximin mediatik dhe do t'i aftësojë njerëzit të fitojnë njohuri të vërteta.

Përndryshe, rreziku është të fitohet, nëse asgjë tjetër, vetëm një njohuri sipërfaqësore dhe informata të thata. Të kihet qasje në gjithçka pa mësuar asgjë.



Te shkrim-leximi mediatik nuk bëhet fjalë vetëm për mendim racional, logjik. Inteligjenca emocionale, kreativiteti, intuïta dhe vetëdija për sjellje personale në internet janë kualitete të cilat duhet të ruhen, që mediet të shfrytëzohen si resurs i vërtetë personal.

Hapi i parë i nevojshëm për zgjidhjen e çdo lloj problemi është njeriu të jetë i vetëdijshëm për të. Duke shfrytëzuar mediet, doemos duhet të jemi të vetëdijshëm se i jemi nënshtruar propagandës ose se në internet shpenzojmë orë të tëra. Gjithashtu, duhet të jemi të vetëdijshëm se është iluzion të mendojmë se ne jemi ata që me të vërtetë kemi zgjedhur se cili është filmi i ardhshëm që do ta shikojmë në televizor këtë mbrëmje.

2 Vetëdija për emocionet

Zhvillimi i vetëdijes është komponenti esencial i të qenit person i arsimuar mediatik.

Më e rëndësishme është të jemi të vetëdijshëm se në internet vazhdimisht na e tërheqin vëmendjen me arsye, për shkak të një interesi të huaj komercial ose politik. Korporatat e rrjeteve sociale i bazojnë strategjitë e tyre në shkencat biheavioristike, për t'i shfrytëzuar dobësitë e njerëzve. Varshmëria nga ekrani dhe problemet shëndetësore lidhur me të janë shembull tjetër të nevojës për ndryshim të qëndrimeve të caktuara biheaviorale kur jeni në bashkëveprim me mediet.

Për të jetuar më mirë me mediet, me rëndësi esenciale është të bëhemi të vetëdijshëm për atë se çka bëjmë dhe si sillemi në internet. Aftësia për ta vëzhguar sjelljen tonë personale është hapi i parë drejt çrrënjosjes së rezultateve negative. Sipas kësaj, procesi për arritjen e vetëdijes është të mësuarit e të vërejturit.

Me fjalë të tjera, që të bëhemi të arsimuar mediatikë është e nevojshme të zhvillojmë kapacitetet për njohjen e ndjenjave si hidhërim ose kënaqësi, të kuptohet se pse këto emocione ndikojnë në zgjedhjet tona, dhe kështu të mësohet se si të zhvillohen reflekse më të mira.



Për t'i shfrytëzuar mediet si resurs të vërtetë personal, njerëzit duhet të jenë të aftë t'i shfrytëzojnë mirë prodhimet, shërbimet dhe teknologjitë e veçanta. Nuk është e nevojshme të përmendet se, në një rreth digjital-online arritja e shkathtësive adekuate teknike është me rëndësi esenciale.

Prandaj, kur njerëzit një herë i kanë vlerësuar dobinë dhe pasojat nga shfrytëzimi i tyre i medieve, *ata duhet të jenë të aftë për t'i shfrytëzuar ato teknologji në mënyrë të sigurt për argëtim*, për informata ose për qëllime arsimore.

Për ta bërë këtë, njerëzve u duhen aftësi teknike, digjitale. Kjo mund të përfshijë gjithçka, nga aftësia për t'i kyçur dhe ç'kyçur aparatet, t'i përshtatin tezat e rrjeteve sociale ose të refuzojnë pajtimin e personave të tretë për t'i shfrytëzuar informatat dhe të dhënat e tyre personale.

3 Mirëqenia digjitale

Me paraqitjen në internet të gjërave dhe inteligjencës artificiale⁹, që premtojnë të vendosin shumë vegla të reja në jetët tona, në automjetet tona, në shtëpitë dhe veshjet tona, njerëzit duhet të posedojnë shkathtësi teknike që të mund të zotërojnë plotësisht me këto teknologji dhe për këtë duhet të jenë të aftë të vendosin se çka do të bëjnë me to, dhe si dhe kur dëshirojnë t'i shfrytëzojnë.

Meqë pranohet se njerëzit mund të mos dëshirojnë dhe të mos jenë të aftë të fitojnë shkathtësi teknike komplekse, tregjet dhe dosjet e tyre me politika relevante që merren me atë që u tha më lartë, duhet të sigurohen se dhënësit e prodhimeve dhe shërbimeve u mundësojnë shfrytëzuesve të medieve realisht t'i zotërojnë mediet e tyre.

Prandaj njerëzit, këtu të konsideruar si konsumatorë, duhet të mund ta shfrytëzojnë teknologjinë për ta rritur mirëqenien e tyre dhe për dobinë e tyre personale.

Teknologjia, në këtë kontekst duhet tu shërbejë nevojave të njerëzve, dhe jo anasjelltas.

⁹ Duhet të vërehet se Këshilli i Evropës vëllimshëm e hulmonit inteligjencën artificiale, duke përfshirë edhe në pikëpamje të të drejtave të njeriut, www.coe.int/en/web/artificial-intelligence.



Kur një herë njerëzit t'i kenë përsosur shkathtësitë e tyre individuale të përshkruara më lartë, duhet të inkurajohen të mësojnë mirë se si të kontribuojnë për një mirëqenie më të mirë komunikative.

Së pari, shfrytëzuesit duhet secili veçmas të mësojnë se si të lidhen në mënyrë përkatëse dhe të ndajnë përmbajtje me të tjerët. Për shembull, kur do të ndeshen me gjuhën e urrejtjes ose kiber-dhunë, shfrytëzuesit duhet të kenë shkathtësi ta njohin si negative dhe të dëmshme dhe të përcaktojnë se cilin veprim përkatës të ndërmarrin, nëse një i tillë ekziston.

4 Qytetaria me të drejta të plota

Së dyti, qytetarët duhet të mund të marrin pjesë në shoqëritë pjesë e të cilave janë vet ata. Sot, kjo pjesëmarrje është kryesisht nëpërmjet medieve, shtrihet jashtë kufijve shtetërorë dhe prandaj është globale. Qytetarët mund të vendosin, për shembull, të marrin pjesë në lëvizje që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike, paqen botërore ose të drejtat e njeriut, si dhe në jetën e shtetit të tyre nacional. Kjo është pjesëmarrje, nëpërmjet medieve, që pozitivisht ndikon në zhvillimin e shoqërisë globale.

Pranojmë se në nxitjen e pjesëmarrjes domethënëse, rol të rëndësishëm luajnë përparimi i pluralizmit mediatic, liria e medieve dhe gazetaria kualitative. Prandaj, trupat arsimues, institucionet politike, mediet dhe organizatat qytetare, të gjitha luajnë rol dhe kanë përgjegjësi në lehtësimin e këtij procesi.

Konceptet e lartpërmendura përkujtojnë ato për qytetari digjitale dhe demokraci digjitale dhe janë të lidhura me çështjet e shqyrtuara gjerësisht së fundmi siç janë përzjerja në kampanja zgjedhore nëpërmjet internetit, përlëshja me informatat dhe populizmin që përhapet nëpërmjet rrjeteve sociale.



Agjencia do të planifikojë, iniciojë, mbështesë dhe do të njoftojë, do të mbajë, kryejë, koordinojë ose do të mundësojë aktivitete me qëllim që t'u ndihmohet qytetarëve të Maqedonisë së Veriut të pajisen me kompetenca për shkrim-lexim mediatik të ekspozuara në faqet paraprake.

Duke pasur parasysh se kjo është ndërhyrje e përvetshme, ajo do t'i orientojë aktivitetet e veta drejt grupeve të ndryshme shoqërore, duke u adaptuar në realitetin aktual¹⁰ dhe mundësitë, në bazë të përvojës paraprake.

Roli i Agjencisë

Do të punojë vet ose në bashkëpunim me faktorë të ndryshëm – edhe ata që janë anëtarë të Rrjetit për shkrim-lexim mediatik edhe ata që nuk janë. Do të jetë aktive në projektet dhe ngjarjet ndërkombëtare dhe nacionale.

Çdo herë do të jetë e hapur drejt ngjarjeve dhe trendeve të reja në sferën e shkrim-leximit mediatik, si brenda vendit po ashtu edhe jashtë tij.

Agjencia do të punojë në nxitjen e çdo aktiviteti të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që do të kontribuonte për shkathësi më të mira të qytetarëve për shkrim-lexim mediatik, për mirëqenien e tyre mediatike dhe pjesëmarrjen në shoqëri nëpërmjet medieve.

¹⁰ „Hulumtimi për shkrim-leximin mediatik ndërmjet popullatës së të rriturve në Republikën e Maqedonisë“ (2016), i qasshëm: <http://medi-umskapismenost.mk/istrazuwanja-avmu/>.

Trupi rregullator mediatik maqedonas - Agjencioni për shërbime audio dhe audio-vizuele mediatike, i shfrytëzon kompetencat dhe obligimin të inkurajojë shkrim-leximin mediatik në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga ligji. Kjo rezultoi me nevojën e krijimit të këtij dokumenti gjithëpërfshirës për politikën e shkrim-leximit mediatik. Qëllimi i këtij dokumenti ishte të jep një pasqyrë për mënyrat e përparimit të punës në fushën e shkrim-leximit mediatik, njëkohësisht duke theksuar specifikat e punës së trupit rregullator mediatik në këtë fushë.

Dokumenti për politika në veçanti i thekson:

- Objektivat kryesore që duhet të arrihen në fushën e shkrim-leximit mediatik në Maqedoninë e Veriut, nga agjencioni dhe partnerë të tjerë;
- Sferat kryesore me interes primar, ku përpjekjet më së shumti do të ndihmonin në arritjen e atyre objektivave;
- Kompetencat e shkrim-leximit mediatik dhe informatik të zhvillohen në grupe të ndryshme të shoqërisë

Ky dokument e merr parasyshë kornizën më të gjërë të politikave Evropiane për arsimimin mediatik, njëkohësisht duke u fokusuar konkretisht në aktivitetet/përvojën e Agjencionit dhe faktorëve të tjerë në Maqedoninë Veriore.

ALB

